

**LEVIZALBANIA**

**UDHËZUES I THIRRJES Nr. 3 PËR APLIKIME**

**GRANTE STRATEGJIKE**

**'Demokracia Digjitale në Nivel Vendor'**

**1 SHTATOR 2021**

Një projekt i Agjencisë Zvicerane SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim  
dhe Bashkëpunim SDC

ZBATUAR NGA



FONDACIONI SHOQËRIA  
E HAPUR PËR SHQIPËRINË



**PARTNERËT SHQIPËRI**  
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM



**LevizAlbania** synon forcimin dhe përmirësimin e demokracisë vendore në Shqipëri përmes angazhimit të shoqërisë civile dhe individëve. LevizAlbania është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) që zbatohet nga konsorciumi i tre organizatave shqiptare: "Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë", "Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim" dhe "Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit".

**LevizAlbania**, nëpërmjet Granteve Strategjike mbështet krijimin e një mjedisi mundësues për forcimin e aktorëve të shoqërisë civile, formalë dhe jo-formalë, dhe rritjen e angazhimit qytetar me qëllim institucionalizimin e llogaridhënies dhe qeverisjes pjesëmarrëse në nivel vendor.

**LevizAlbania** fton organizatat jo fitimprurëse (OJF) të aplikojnë në Thirrjen Nr. 3 për Aplikime, Grante Strategjike '*Demokracia Digjitale në Nivel Vendor*' me qëllim '*normalizimin*' dhe zgjerimin e demokracisë digjitale si instrument për rritjen e pjesëmarrjes qytetare dhe transparencës së qeverisjes vendore.

Të interesuarit ftohen të aplikojnë në drejtimet e mëposhtme:

*Drejtimi 1: E-pjesëmarrje: mundësimi i aktivizmit digjital në nivel vendor (1 grant);*

*Drejtimi 2: Teknologji dhe qytetarë të zgjuar për demokracinë vendore (1 grant)*

**Këto drejtime synojnë mundësimin e lidershit strategjik për të: (i) identifikuar, pilotuar dhe konsoliduar instrumente të demokracisë digjitale, (ii) aftësuar qytetarët për t'i përdorur si dhe (iii) shpërndarë modelet e zbatuara dhe njohuritë e përfutuara.**

Ky udhëzues shërben për të ofruar informacionet e nevojshme mbi hapat, rregullat dhe procedurat e kësaj thirrje për të gjithë të interesuarit që do të aplikojnë me **Projekt Propozime** në Thirrjen Nr. 3 për Aplikime, Grante Strategjike. Udhëzuesi shpjegon hapat, procedurat, dokumentacionin e kërkuar, rregullat dhe afatet e të gjithë procesit të Thirrjes, që nga hapja e saj, fazat pasardhëse dhe deri në përfundim të thirrjes.

Të gjitha Organizata Jofitimprurëse, që janë të interesuar të aplikojnë pranë LevizAlbania janë të lutur që për çdo informacion apo paqartësi të na shkruajnë në [info@levizalbania.al](mailto:info@levizalbania.al) ose të kontaktojnë në numrin e telefonit +355 67 603 6732.

### 1. Kush mund të aplikojë?

Thirrja për Aplikime i drejtohet **VETËM** Organizatave Jo-fitimprurëse me eksperiencë të konsoliduar në fushat dhe prioritetet e specifikuar nga LevizAlbania në këtë Thirrje.

**KUJDES! PËR TË APLIKUAR NË INSTRUMENTIN E GRANTEVE STRATEGJIKE ORGANIZATAT JO-FITIMPRURËSE DUHET TË VIJNË NË FORMËN E KOALICIONIT TË PËRBËRË NGA TË PAKTËN TRE ORGANIZATA QË NË KËTË FAZË TË APLIKIMIT.**

### 2. Grantet Strategjike

LevizAlbania përmes instrumentit të Grantëve Strategjike synon ndryshime *sistemike* në cilësinë e demokracisë vendore në Shqipëri. Grantet strategjike synojnë të ndikojnë në politika në nivel vendor dhe agjendën kombëtare për ndryshime dhe përmirësime në strategji, akte normative, udhëzime, përqasje etj, të cilat përmirësojnë demokracinë vendore and forcojnë angazhimin qytetar.


Projekt propozimet në Thirrjen Nr. 3 për Aplikime, Grante Strategjike duhet të fuqizojnë rrjetet dhe koalicionet ekzistuese ose mundësojnë rrjete dhe koalicione të reja për të ndërmarrë nisma me rezultate të prekshme nëpërmjet advokimit strategjik dhe angazhimit të qëndrueshëm qytetar bazuar në rrjetëzim dhe koalicione tematike.

Projekt propozimet në Thirrjen Nr. 3 për Aplikime, Grante Strategjike duhet të zbatojnë qasje advokuese përfshirëse të bazuara në të dhëna/prova, analiza të thelluara dhe zbatimin/pilotimin e modeleve të reja të angazhimit qytetar cilat mundësojnë arritjen e rezultateve të prekshme nëpërmjet ndërveprimit midis qytetarëve dhe qeverisjes vendore.

### 3. Qëllimi dhe Objektivat e Thirrjes

Digjitalizimi i ndërveprimeve shoqërore - i shtuar eksponencialisht gjatë COVID-19 - paraqit sfida dhe mundësi për zgjerimin e demokracisë vendore dhe hapësirës qytetare. Kjo mundësi duhet të shfrytëzohet edhe nga aktorët e shoqërisë civile shqiptare për të ristrukturuar mënyrën se si komuniteti bashkëvepron me institucionet për të ndikuar në prioritetet dhe politikë-bërje. Prandaj, LevizAlbania (LA), për të mundësuar shfrytëzimin e instrumentave digjitalë për përmirësimin e demokracisë dhe rritjen e aktivizmit, do të mbështesë ndërhyrjet sipas drejtimeve të mëposhtme:

Një projekt i Agjencisë Zvicerane SDC



ZBATUAR NGA



*Drejtimi 1: E-pjesëmarrje: mundësimi i aktivizmit digjital në nivel vendor (1 grant);*

*Drejtimi 2: Teknologji dhe qytetarë të zgjuar për demokracinë vendore (1 grant)*

**Qëllimi** kryesor i thirrjes është 'normalizimi' dhe zgjerimi i demokracisë digjitale<sup>1</sup> në nivel vendor si mjet për rritjen e pjesëmarrjes dhe transparencës. Specifikisht, **objektivat** e granteve janë: 1) të rrisin përdorimin e demokracisë digjitale nga autoritetet vendore, shoqëria civile dhe qytetarët duke pilotuar instrumente të ndryshëm, 2) t'i mundësojnë qytetarëve, veçanërisht në zona të largëta, të përdorin efektivisht instrumentet e demokracisë digjitale, 3) të vënë në jetë mekanizma të përsëritshëm (të kopjueshëm) për zbatimin e demokracisë digjitale dhe 4) të shpërndajnë njohuritë e përfutuara në mënyrë të strukturuar.

LevizAlbania pret **rezultatet** e mëposhtme nga Thirrja Nr. 3 për Aplikime 'Demokracia Digjitale në Nivel Vendor':

- **Krijimi i mekanizmave konkret** për zbatimin e demokracisë dhe pjesëmarrjes digjitale;
- **Pilotim** i instrumenteve të demokracisë digjitale në bashki të ndryshme për të vlerësuar përshtatshmërinë e tyre me kontekstin e Shqipërisë;
- **Rritje e aftësive të qytetarëve dhe aktivistëve** për të përdorur instrumentet e demokracisë digjitale;
- **Rritje e nismave dhe pjesëmarrjes qytetare** bazuar në demokracinë digjitale;
- **Shpërndarja e njohurive** të përfutuara me aktorë të tjerë të shoqërisë civile.

Organizatat e interesuara pritet të zbatojnë qasje inovative dhe ndërmarrin veprime konkrete që mundësojnë demokracinë digjitale në nivel vendor.

Organizatat e interesuara duhet të:

- Demonstrjnë **eksperiencë dhe njohuri të thella** mbi instrumentet e demokracisë digjitale;
- Prezantojnë **qasje koherente, konkrete dhe inovative** për zbatimin e instrumenteve të demokracisë digjitale në nivel vendor;

---

<sup>1</sup> Për qëllimet e kësaj thirrje, demokracia digjitale do të kuptohet si pjesëmarrja në procese politike përmes instrumenteve digjitale të bazuara në Internet të cilat mundësojnë lidhjen e drejtpërdrejtë të qytetarit me institucionet e administratës publike vendore për të ndikuar në agjendë, politika dhe vendimmarrje.

## Udhëzues i Thirrjes Nr. 3 për Aplikime, Grante Strategjike 'Demokracia Digjitale në Nivel Vendor'

- Demonstronë aftësi për të *koordinuar aktivitetet* të njëkohshme midis aktorëve të ndryshëm në nivel vendor dhe/ose qendror;
- Krijonë dhe zbatonë *mekanizma të përsëritshëm (kopjueshëm)* që mundësojnë përhapjen e demokracisë digjitale në nivel vendor;
- Ndërmarrin aktivitete të strukturuar për *përhapjen e modeleve të zbatuara dhe njohurive të përftuara*.

#### 4. Arsyetimi

Në Shqipëri demokracia digjitale mbetet në faza embrionale. Pavarësisht sukseseve të arritura në shumë vende post-komuniste në këtë fushë, në Shqipëri mungojnë, ose janë në fazë embrionale dhe jo-gjithëpërfshirëse, programe të strukturuar që mundësojnë demokracinë digjitale veçanërisht në nivel vendor.

Qartësisht ka nevojë për leadership strategjik për mbështetjen e demokracisë digjitale në nivel vendor në Shqipëri. LevizAlbania është platforma ideale për ta mundësuar këtë leadership duke mbështetur ndërhyrje të cilat: (i) krijojnë mekanizma të përsëritshëm që mundësojnë 'normalizimin' dhe zgjerimin e demokracisë digjitale; dhe (ii) ndërtojnë dhe pilotojnë instrumente të demokracisë digjitale. Të dy ndërhyrjet që do të mbështeten nga LevizAlbania i qasen demokracisë digjitale nga këndvështrime plotësuese. E para mbështet pilotimin e instrumenteve të demokracisë digjitale për të vlerësuar realizueshmërinë e tyre dhe rritur familjaritetin e qytetarëve me to. E dyta përqendrohet tek përdoruesit – qytetarët – për të mundësuar krijimin e 'e-qytetarëve' të aftë të përdorin instrumentet e demokracisë digjitale.

Së bashku këto dy ndërhyrje synojnë të krijojnë, pilotojnë dhe përhapin mekanizma për zbatimin e demokracisë digjitale dhe të aftësojnë qytetarët në përdorimin efektiv të tyre për të ushtruar presion mbi të zgjedhurit vendor për më shumë demokraci dhe shërbime më të mira.

### DREJTIMI 1: E-PJESËMARRJE: MUNDËSIMI I AKTIVIZMIT DIGJITAL NË NIVEL VENDOR

**Qëllimi kryesor i ndërhyrjes nën këtë drejtim është pilotimi dhe përhapja e instrumentave të demokracisë digjitale për të rritur pjesëmarrjen dhe transparencën në nivel vendor.**

Qytetarët shqiptarë kanë nivel të ulët të pjesëmarrjes në proceset demokratike në nivel vendor e cila buron, ndër të tjera, nga mosbesimi tek institucionet. Mungesa e transparencës dhe llogaridhënies ka krijuar një rreth vicioz duke ulur besimin e qytetarëve tek forca e tyre pasi shumica (78.9%) besojnë se organizatat ndërkombëtare janë më efektive në vënien e qeverisë përpara përgjegjësisë.<sup>2</sup>

<sup>2</sup> UNDP Albania, 2020. [https://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/blueprint\\_governance/-trust-in-governance--opinion-poll-2019-.html](https://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/blueprint_governance/-trust-in-governance--opinion-poll-2019-.html)

## Udhëzues i Thirrjes Nr. 3 për Aplikime, Grante Strategjike 'Demokracia Digjitale në Nivel Vendor'

Kjo është një nga arsyet pse Raporti i Komisionit Evropian 2019 për Shqipërinë vërejtë se "rritja e transparencës dhe përgjegjësisë, [...], mbetet [sfidë] thelbësore".<sup>3</sup> Me kalimin e viteve, mungesa e transparencës dhe përgjegjësisë ka thelluar hendekun mes qytetarëve dhe institucioneve vendore duke stimuluar apatinë.

Pavarësisht reformës administrative-territoriale të vitit 2015 dhe kuadrit mbështetës ligjor, qytetarët mbeten mosbesues e si rrjedhojë mospjesëmarrës. Qartësisht instrumentet ekzistuese për të mundësuar pjesëmarrjen qytetare janë të pamjaftueshme.

Në vendet me kulturë demokratike të konsoliduar, pjesëmarrja qytetare kalon nëpër kanale të strukturuar që mundësojnë presion ndaj institucioneve vendore për të kultivuar përgjegjësi. Midis kanaleve të ndryshme, demokracia digjitale është bërë gjithnjë e më tërheqëse si mjet lehtësisht i përdorshëm dhe efektiv për zgjerimin e hapësirës dhe angazhimit qytetar. Instrumentet digjitale janë përdorur gjerësisht, dhe me sukses, për të grumbulluar preferencat, mundësuar vendimmarrjen dhe caktuar prioritetet qeverisëse. Këto instrumente mundësojnë kapërcimin e barrierave institucionale, logjistike dhe historike ndaj pjesëmarrjes qytetare. Çfarë është më e rëndësishme, këto instrumente janë në gjendje të përmirësojnë marrëdhëniet midis qytetarëve dhe institucioneve duke rritur besimin pasi, sipas studiuesve<sup>4</sup>, ato mundësojnë më shumë informacion për qytetarët, lehtësojnë aplikimin e presionit qytetar dhe rrisin përgjegjshmërinë e vendimmarrësve. Kësisoj, gjithmonë e më shumë instrumentet digjitale janë bërë një zgjidhje efektive për të trajtuar shumë sfida të pjesëmarrjes qytetare sidomos në nivel vendor.

Pavarësisht suksesit në shumë vende, në Shqipëri ka patur pak ndërhyrje të strukturuar në këtë drejtim kryesisht të përqendruara në peticione elektronike apo buxhetim me pjesëmarrje. Rrjedhimisht, ekziston një nevojë e qartë për të identifikuar, pilotuar dhe përhapur instrumentet që mundësojnë demokracinë digjitale edhe në Shqipëri. Një ndërmarrje e tillë është e rëndësishme pasi aktivizmi digjital në nivel vendor mund të kapërcejë pengesat strukturore ndaj pjesëmarrjes e të përmirësojë sasinë dhe përfaqësueshmërinë e qytetarëve pjesëmarrës.<sup>5</sup>

Nga gjithë sa më sipër është e qartë se ka nevojë për leadership strategjik për sa i përket mundësimit të demokracisë digjitale në Shqipëri për të tejkaluar apatinë qytetare dhe rritur besimin e qytetarëve tek institucionet dhe të zgjedhurit e tyre në nivel vendor. Kësisoj, kjo ndërhyrje pritët të ndërmarrë, por jo

<sup>3</sup> Komisioni Evropian, 2019. <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-albania-report.pdf>

<sup>4</sup> Erkul dhe Erkul 2009. <https://scholarworks.umass.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1031&context=ncdg>

<sup>5</sup> Pratchett, 2013. <https://www.taylorfrancis.com/books/mono/10.4324/9781315038421/renewing-local-democracy-lawrence-pratchett>

## Udhëzues i Thirrjes Nr. 3 për Aplikime, Grante Strategjike 'Demokracia Digjitale në Nivel Vendor'

të kufizohet në, disa nga veprimet e mëposhtme të cilat reflektohen edhe në draft-planin e aktiviteteve të paraqitur si shembull ilustrues:

- i. Përdorimi i demokracisë digjitale në nivel vendor:
  - a) Analizë e praktikave të suksesshme të zbatimit të demokracisë digjitale;
  - b) Identifikim i preferencave të qytetarëve në lidhje me demokracinë digjitale.
- ii. Ndërtim dhe pilotim i instrumenteve të demokracisë digjitale për të vlerësuar realizueshmërinë e tyre dhe rritur angazhimin qytetar në nivel vendor:
  - a) Përfshirja e qytetarëve në identifikimin e problemeve në komunitet (shembull: metoda e *crowdmapping*);
  - b) Përfshirja e qytetarëve në zgjidhjen e problemeve në komunitet (shembull: metoda e *crowdsourcing*);
  - c) Agregimi i opinionit qytetar me instrumenta të tërthorta (shembull: metoda e *social [media] listening*).
- iii. Shpërndarja e njohurive dhe të dhënave të përfuara mbi instrumentat e pilotuar me aktorë të tjerë në nivel vendor dhe qëndror.

Tabela 1: Draft-Plani i Aktiviteteve<sup>6</sup>

Aktivitete	M1	M2	M3	M4	M5	M6	M7	M8	M9	M10	M11	M12	M13	M14
1. Zhvillimi i strategjisë së zbatimit dhe ndërtimi i partneriteteve të koalicionit zbatues														
2. Analizë e praktikave e modeleve (kombëtare e ndërkombëtare) të demokracisë digjitale dhe përshtatshmërisë me ndërhyrjen														
3. Studim i qasjes qytetare ndaj pjesëmarrjes në zonën e zbatimit të ndërhyrjes														
5. Dizenjim i ndërhyes strategjike të bazuar mbi instrumentat e demokracisë digjitale														
6. Ndërtim dhe pilotim i instrumentave të dizenuar në bashkitë e përzgjedhura														

<sup>6</sup> Ky draft-plan është një shembull i pritshmërive të LA mbi tipologjinë dhe logjikën e aktiviteteve. Afati maksimal i zbatimit të ndërhyrjes është 18 muaj (pika 6 e Udhëzuesit, Madhësia e granteve dhe afati i zbatimit).

Një projekt i Agjencisë Zvicerane SDC

ZBATUAR NGA







fragmentojnë hapësirën qytetare duke dobësuar kohezionin social dhe demokracinë pjesëmarrëse edhe në nivel vendor.

Rreziqet e mësipërme shfaqen në shumë mënyra. Për shembull, pavarësisht se të rinjtë kanë aftësi digjitale, ato janë të prekshëm nga manipulimi dhe filtrat e informacionit pasi kanë aftësi sociale më pak të zhvilluara dhe lidhje më të dobëta me komunitetin.<sup>9</sup> Po aq e rëndësishme, grupet e marginalizuara – të moshuarit, gratë kryefamiljare, personat me aftësi të kufizuara dhe grupet shoqërore në 'periferi të shoqërisë' – shpesh u mungojnë aftësitë digjitale duke penguar kështu mundësitë për pjesëmarrje.<sup>10</sup> Nëse rreziqe/boshllëqe të tilla nuk trajtohen, në vend që të zgjerojë aksesin, digjitalizimi i proceseve demokratike rrezikon të thellojë më tej pabarazitë ekzistuese. Prandaj është e rëndësishme të adresohen këto problematika, në mënyrë që potenciali i digjitalizimit jo vetëm të përmbushet, por edhe t'i arrijë të gjithë. Në mënyrë që e-pjesëmarrja të tejkalojë pabarazitë ekzistuese, është thelbësore të përfshihen grupet e marginalizuara. Kjo është arsyeja pse aftësimi digjital është kyç për të trajtuar 'anën e errët' të digjitalizimit.<sup>11</sup>

Meqenëse e ardhmja e angazhimit qytetar dhe demokracisë është online, proceset pjesëmarrëse vendore duhet të digjitalizohen në mënyrë të sigurtë dhe përfshirëse. Demokracia digjitale vendore nuk mund të jetë e sigurtë dhe efektive pa ngritjen e njohurive dhe vetëdijes qytetare mbi aksesin, privatësinë, mbrojtjen e të dhënave dhe aftësimin digjital. Prandaj, adresimi i pabarazive të aksesit në proceset digjitale, shfrytëzimi i potencialit të teknologjisë për pjesëmarrjen qytetare, mbrojtja e të drejtave digjitale dhe aftësimi digjital i qytetarëve përbëjnë parakushte thelbësore që demokracia digjitale të përmbushë potencialin për zgjerimin e pjesëmarrjes qytetare dhe rritjen e transparencës qeverisëse.

Nga sa më sipër është e qartë se teknologjia e 'zgjuar' nuk është e mjaftueshme për të zgjeruar demokracinë në nivel vendor. Nevojiten gjithashtu 'e-qytetarë' të aftë të përdorin instrumentet digjitale për të vlerësuar, gjykuar dhe ndërmarrë aktivizëm të qëndrueshëm në nivel vendor. Kjo ndërhyrje pritet të ndërmarrë, por jo të kufizohet në, disa nga nismat e mëposhtme të cilat reflektohen edhe në draft-planin e aktiviteteve të paraqitur si shembull ilustrues:

- i. Mundësimi i e-qytetarisë:
  - a) Familjarizimi/angazhimi i qytetarëve dhe grupeve të interesit me instrumentet e demokracisë digjitale:

<sup>9</sup> Bradshaw dhe Howard. 2017. <https://fpmag.net/wp-content/uploads/2017/11/Troops-Trolls-and-Troublemakers.pdf>

<sup>10</sup> Park dhe Humphry, 2019. <https://www.tandfonline.com/doi/abs/10.1080/1369118X.2019.1606266>

<sup>11</sup> Trittin-Ulbrich, et.al., 2021. <https://journals.sagepub.com/doi/full/10.1177/1350508420968184>

## Udhëzues i Thirrjes Nr. 3 për Aplikime, Grante Strategjike 'Demokracia Digjitale në Nivel Vendor'

- i. Njohja me platformat që mundësojnë e-demokracinë;
  - ii. Vlerësim i njohurive/aftësive komunitare për e-demokracinë.
- ii. Ndërtim dhe pilotim i instrumenteve të aftësimit digjital në lidhje me:
    - a. E-demokracinë;
    - b. Kërcënimet ndaj privatësisë dhe mbrojtjen e të dhënave;
    - c. Ngushtimin e pabarazive digjitale;
    - d. Aftësimin e komuniteteve të marginalizuara në shoqëri.
  - iii. Shpërndarja e njohurive dhe të dhënave të përfuara mbi instrumentet e pilotuar me aktorë të tjerë në nivel vendor dhe qendror.

Tabela 2: Draft-Plani i Aktiviteteve<sup>12</sup>

Aktivitete	M1	M2	M3	M4	M5	M6	M7	M8	M9	M10	M11	M12	M13	M14	M15
1. Zhvillimi i strategjisë së zbatimit dhe ndërtimi i partneriteteve të koalicionit															
2. Vlerësim i njohurive dhe aftësive të komunitetit për demokracinë digjitale															
3. Vlerësimi i aksesit dhe kapaciteteve të komunitetit për demokracinë digjitale															
4. Dizenjimi i ndërhyrjes strategjike bazuar në gjetjet e pikës 2 dhe 3															
5. Pilotim i ndërhyrjes në bashkitë e përzgjedhura															
6. Analiza dhe publikimi i gjetjeve të pilotimit.															
7. Shpërndarja e njohurive mbi instrumentat e pilotuar															

<sup>12</sup> Ky draft-plan është shembull i pritshmërive të LA mbi tipologjinë dhe logjikën e aktiviteteve. Afati maksimal i zbatimit të ndërhyrjes është 18 muaj (pika 6 e Udhëzuesit, Madhësia e granteve dhe afati i zbatimit).



## Udhëzues i Thirrjes Nr. 3 për Aplikime, Grante Strategjike 'Demokracia Digjitale në Nivel Vendor'

- Lista e Dokumentave Mbështetëse. Sipas listës të vënë në dispozicion nga LevizAlbania, e detyrueshme dhe për OJF-të partnere pjesë e koalicionit.

**Kujdes! Sigurohuni që të gjithë dokumentet në këtë listë të jenë pjesë e paketës të aplikimit. Mungesa e dokumentave pjesë e kësaj liste, mund të penalizojë aplikimin tuaj për hapat e mëtejshme të vlerësimit.**

**NUK LEJOHET NDRYSHIMI I FORMATEVE TË DOKUMENTAVE TË APLIKIMIT**

### 7.2 Kush mund të aplikojë?

Koalicionet e përbëra nga organizatat të cilat kanë:

- ✓ Njohuri të thella dhe ekspertizë të provuar mbi krijimin dhe zbatimin e instrumentave të pjesëmarrjes dhe demokracisë digjitale;
- ✓ Eksperiencë të mëparshme të provuar në hartimin e studimeve, nxjerrjen e mësimave, zbatimin e modeleve të suksesshme dhe përhapjen e njohurive të përfutuara;
- ✓ Eksperiencë të mëparshme në zhvillimin e shoqërisë civile, angazhimin qytetar dhe aktivizmin digjital në nivel vendor;
- ✓ Eksperiencë pune të gjerë dhe të provuar në advokim, politika, fushata, dhe menaxhim strategjik veçanërisht të lidhura me instrumentat e pjesëmarrjes digjitale në nivel vendor;
- ✓ Eksperienca në realizimin e detyrave/projekteve të ngjashme është vlerë e shtuar.

### 7.3 Informacion Shtesë

Nuk mund të pranohen aplikime/projekt propozime nga organizata të shoqërisë civile që kanë të përfshirë në strukturat e tyre, apo në grupet e punës të propozuar:

- o persona që janë në një konflikt interesi, në lidhje me statusin e tyre profesional ose personal;
- o persona që janë të punësuar në projekte të organizatave/donatorëve ndërkombëtarë;
- o persona që janë të punësuar në administratën publike apo që janë pjesë e organeve të zgjedhura qendrore apo vendore;

**LevizAlbania kërkon nga aplikantët që në hartimin e projekt propozimeve të tyre:**

- të përfshijnë **perspektivën gjinore**;
- të **bashkëpunojnë me gazetarë dhe media** për të advokuar apo për të shpërndarë në publik mesazhet kryesore;

Një projekt i Agjencisë Zvicerane SDC

ZBATUAR NGA

### LevizAlbania NUK mbështet projekte/aktivitete që synojnë:

- Ofrimin e shërbimeve sociale;
- Realizimin e kompetencave/detyrave të pushtetit vendor;
- Trajnime të administratës vendore;

### 8. Hapat e Thirrjes Nr. 3 për Aplikime Grante Strategjike

Dhënia e një granti strategjik kalon në disa faza, si më poshtë:

- ✓ Thirja për Aplikim që siguron një mekanizëm transparent dhe konkurrues përzgjedhjeje, sipas drejtimeve të thirrjes;
- ✓ Vlerësimi i aplikimeve të paraqitura në formën e projekt-propozimeve të plota, në përputhje me kriteret e vlerësimit të përcaktuara;
- ✓ Njoftimi i aplikantëve lidhur me përzgjedhjen apo mospërzgjedhjen e aplikimit të tyre.

#### • Informimi dhe Aplikimi

Gjatë periudhës që Thirrja Nr. 3 për Aplikime, Grante Strategjike do të qëndrojë e hapur, LevizAlbania do të organizojë një sesion informues online, për secilin nga Drejtimet e Thirrjes. Në sesionet informuese janë të ftuara organizata të shoqërisë civile dhe do të diskutohet mbi fushat dhe prioritetet përkatëse, procedurat e Thirrjes, si dhe do t'i jepet përgjigje pyetjeve që kanë të interesuarit mbi Thirrjen për Aplikime Nr. 3. Sesioni informues do të zhvillohet në **9 Shtator, 2021 ora 11.00**. Sesioni do të zhvillohet përmes platformës Zoom dhe për tu bërë pjesë e tij duhet të regjistroheni duke klikuar në këtë link:


[KLIKO & REGJISTROHU NË SESIONIN INFORMUES TË THIRRJES Nr.3 PËR GRANTE STRATEGJIKE](#)

Menjëherë pas regjistrimit në Zoom Webinar përmes një e-mail automatic do t'ju dërgohen kredencialet për të qenë pjesë e sesionit informues online dedikuar Thirrjes Nr. 3 për Aplikime, Grante Strategjike *'Demokracia Digjitale në Nivel Vendor'*.

### VLERESIMI I PROJEKT PROPOZIMEVE TË PLOTA

Vlerësimi i projekt propozimeve të plota do të kryhet në dy faza:

Një projekt i Agjencisë Zvicerane SDC



ZBATUAR NGA



## Udhëzues i Thirrjes Nr. 3 për Aplikime, Grante Strategjike 'Demokracia Digjitale në Nivel Vendor'

**Faza e parë:** Kontrolli administrativ i paketës së plote të aplikimit. LevizAlbania do të kontrollojë përputhshmërinë e dokumentave të kerkuara në këtë udhëzues të Thirrjes Nr. 3 për Aplikime sikurse dhe kriteret e aplikimit, sipas seksionit 7: **Rregulla të Përgjithshme për Aplikimin dhe Informacion Shtesë.**

**Faza e dytë:** Projekt propozimet të cilët kalojnë procesin e kontrollit administrativ do të shqyrtohen mëtej sipas kriterëve të vlerësimit për Projekt Propozimeve të plota, si më poshtë:


- Kapacitetet teknike, menaxhuese e financiare të organizatës;
- Kapacitetet teknike dhe ekspertiza e anëtarëve të propozuar të grupit të punës;
- Relevanca dhe përputhshmëria e propozimit me qëllimet e Thirrjes;
- Cilësia dhe hartimi i projektpropozimit;
- Përputhshmëria e përmbajtjes së projektpropozimit me buxhetin;
- Eficenca e kostove dhe buxheti realist, duke pasqyruar kostot e tregut në përputhje me veprimtaritë dhe produktet e propozuara;
- Planifikimi i përshtatshëm dhe kalendar realist i veprimtarive;
- Formulimi i një kuadri llogjik të përshtatshëm të projektit.

LevizAlbania do t'i njoftojë aplikantët me shkrim në lidhje me vendimin për projekt-propozimin e paraqitur: (i) aplikantët e suksesshëm, që do të ftohen për negociata të mëtejshme; (ii) aplikantët jo të suksesshëm për këtë Thirrje, do të marrin një përgjigje që përmban një përmbledhje të arsyeve të mospërzgjedhjes.

### 9. E Drejta e Ankimimit

Aplikuesi ka të drejtën e paraqitjes së një ankese, e cila duhet të bëhet jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga data e dërgimit të informacionit me shkrim nga LevizAlbania. Ankesa duhet të dërgohet me shkrim (email ose postë) nga vetë aplikanti dhe të përshkruajë qartë bazën e problemit/ankimimit. Përgjigja i dërgohet ankimuesit jo më vonë se 5 pesë ditë pune nga përfundimi i afatit të ankimimit.

Një projekt i Agjencisë Zvicerane SDC



ZBATUAR NGA

